



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 367/6 prot.

Tiranë, më 23.10.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 276, datë 21.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Brahimi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.10.2020, është njoftuar vendimi nr. 276, datë 21.7.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Brahimi, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 276, datë 21.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit znj. Irena Brahimi ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Irena Brahimi”² ka referuar se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit znj. Irena *** Brahimi, nr. *** prot., datë ***.11.2017, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Irena *** Brahimi”. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për përditësim të raportit, DSIK, me shkresën nr. *** prot., datë ***.8.2019, ka referuar se: “Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijim të ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Irena *** Brahimi, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”.

2.3 **KLJGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, Irena Brahimi.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ,

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë ***.6.2018.

³ Raport i KLGJ-së nr. *** prot., datë ***.2.2019.

provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *trupi gjykues pas analizimit të provave shtesë të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se – duke e parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe në tërësinë e tij kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – kjo mungesë financiare, si dhe pasaktësitë e konstatuara në deklarime, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Irena Brahimi, sipas parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016 [...] (f. 21 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016 dhe bazuar në dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese – në vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, arrin në përfundimin se nuk janë gjetur fakte apo rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm nga subjekti, nëpërmjet funksionit të tij, apo mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme, me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar.*

Komisioni, në këto kushte, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, indiciet dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, nuk u gjetën elemente të mjaftueshme që të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...] (f. 21-22 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *trupi gjykues çmon se rrethanat e sipërcituara nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si rrjedhim, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor që e përcakton atë si prag kualifikimi [...] (f. 32 e vendimit). Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit znj. Irena Brahimi ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, me vendimin nr. 276, datë 21.7.2020, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *“1.Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”*.

4.1 Komisioni, me vendimin nr. 276/1, datë 19.10.2020, “Për korrigjimin e vendimit nr. 276, datë 21.7.2020”, ka vendosur ndryshimin e pikës 2 të dispozitivit të vendimit me këtë përmbajtje: *“2.Transferimin e çështjes civile - me palë ndërgjyqëse: paditës ***,***, e të paditur: Zyra Përmbarimore “***.***.*** & ***” sh.p.k., dhe me objekt: “Kundërshtim i veprimeve përmbarimore”, - të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe të përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.5.2015, pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016”*.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 276, datë 21.7.2020, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Brahimi, nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

10. Komisioneri Publik, duke çmuar se ky vendim, objekt ankimi, shfaq mangësi në hetimin administrativ, konstaton se çështjet e konstatuara, në vlerësim të akteve të administruara përbëjnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor, pasi rezulton se hetimi i Komisionit nuk ka qenë shterues në drejtim të identifikimit

të burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave të ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive mbi të cilat ushtron të drejta subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioneri Publik vlerëson të nevojshme rishikimin e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për periudhën e deklarimit. Për sa kohë, eventualisht, konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit realizohet pasi është analizuar secili nga kriteret përkatëse, por edhe në një vlerësim të përgjithshëm të procedurave, Kolegji do të mund ta ushtrojë juridiksionin e tij rivlerësues/kontrollues për të tria kriteret e rivlerësimit.

12. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 276, datë 21.7.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Kontrolli i pasurisë

13. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Komisioneri Publik, në vlerësim të kriterit të pasurisë, është bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, të cilat, në gjendjen që janë, paraqesin nevojën për riçeljen e hetimit gjyqësor, pasi konstatohet se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues.

15. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, është subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave private periodike për vitet 2003 - 2017 (në vijim DV -20--) dhe në datën 25.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

16. Në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, nga shqyrtimi dhe krahasimi i Deklaratës “Vetting” me deklaratat periodike vjetore, rezulton si vijon:

17. Pasuri e paluajtshme “Apartament banimi me sip. 95.30 m²”, si dhe “Njësi shërbimi me sip. 50 m²”, ndodhur në Gjirokastrë

17.1 Lidhur me pasurinë “Apartament banimi me sip. 95.30 m²”, në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 95.3 m², ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër. Çmimi i blerjes: 2.859.000 lekë dhe 1.650.000 lekë punime shtesë. Burimi i krijimit: kursimet familjare, hua nga motra e subjektit, znj. ***.***.***. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin.

17.2 Në DV-2008⁴, (dorëzuar më datë 24.2.2009), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 95.3 m², ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër, blerë me kontratën e shitblerjes me numër *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.12.2008. Çmimi i blerjes: 2.850.000 lekë. Në apartament janë kryer punime shtesë në vlerën 1.650.000 lekë. Totali i vlerës së apartamentit është 4.509.000 lekë. Pjesa takuese: ½ pjesë në bashkëpronësi bashkëshortore. Burimi i krijimit: Si burim për blerjen e pasurisë (nuk ka ndarje për të dyja apo vetëm apartamentin) janë deklaruar: (1) kursimet familjare të deklaruara më parë, në shumën 2.300.000 lekë; (2) kursimet e realizuara gjatë vitit 2008, në shumën 1.100.000 lekë; (3) të ardhurat nga dhënia në përdorim e ambientit dhe (4) hua.

17.2.1 Në rubrikën: “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, deklaron: Hua, në shumën 30.000 euro, marrë nga shtetasja ***.***.***, për blerjen e apartamentit dhe ambientit njësi, lidhur me kontratë të thjeshtë, si dhe përshkruan me detaje afatin e shlyerjes dhe shifrave përkatëse.

17.3 Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se origjinë e kësaj pasurie është kontrata e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2008, lidhur midis palës shitëse, shoqërisë “****” sh.p.k., dhe palë blerëse *** dhe Irena Brahimi, me objekt pasurinë me nr.***, zona kadastrale nr. ***, apartament banimi me sipërfaqe 95.3m², me çmim 2.859.000 lekë, likuiduar tërësisht nga ana e blerësve para redaktimit të kësaj kontrate dhe jashtë zyrës së noterisë. Kjo pasuri konfirmohet nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër (ZVRPP Gjirokastër) me shkresën nr. *** prot., datë ***.6.2018, si dhe nga OSHEE, me shkresën nr.*** prot., datë ***.8.2019.

17.4 Lidhur me pasurinë: “Njësi shërbimi me sip. 50 m²”, në D-Vett. (dorëzuar më datë 25.1.2017), subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi pasurinë “njësi”, e cila rezulton si pasuri e tjetërsuar në vitin 2016.

17.5 Në DV-2008 (dorëzuar më datë 24.2.2009), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Ambient me sipërfaqe 50 m², ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër. Çmimi i blerjes: 1.500.000 lekë dhe 900.000 lekë punime shtesë. Burimi i krijimit, kontrata e shitjes, me numër *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.12.2008. Pjesa takuese: ½ pjesë në bashkëpronësi bashkëshortore.

17.6 Në DV-2016 (dorëzuar më datë 27.3.2017), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pakësuar pasuria e patundshme, pasi është shitur njësi e shërbimit, ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastër. me kontratën e shitjes, me numër *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.10.2016. Çmimi i shitjes: 40.000 euro. Pjesa takuese: bashkëpronësi bashkëshortore.

⁴ Po në këtë deklaratë deklaroi edhe pasurinë “Ambient me sip. 50 m²”, gjithashtu përshkruhet se apartamenti dhe ambienti janë marrë të papërfunduar në janar 2008 dhe është vazhduar me punimet shtesë.

17.7 Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se origjinë e kësaj pasurie është kontrata e shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2008, lidhur midis palës shitëse, shoqërisë “****” sh.p.k., dhe palë blerëse *** dhe Irena Brahimi, me objekt pasurinë me nr.***, z. k. nr. ***, njësi me sipërfaqe 50 m², me çmim 1.500.000 lekë, likuiduar tërësisht nga ana e blerësve para redaktimit të kësaj kontrate dhe jashtë zyrës së noterisë. Kjo pasuri, me kontratën nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.10.2016, është shitur te shtetasi ***.***, kundrejt çmimit 40.000 euro, likuiduar para lidhjes së kontratës, nëpërmjet pagesës në llogarinë bankare të personit të lidhur, ***.***, në *** Bank.

17.8 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ për këto dy pasuri, ka konstatuar dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për disa çështje, nga të cilat parashtrihen në vijim ato çështje për të cilat vlerësojmë se hetimi është i paplotë dhe më konkretisht për sa i përket: *(i) analizës financiare për vitin 2007, ku duket se subjekti i rivlerësimit ka një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të përballuar investimet, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara si gjendje cash, prej 2.300.000 lekë; si dhe (ii) analizës financiare për vitin 2008, ku duket se subjekti i rivlerësimit ka një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për blerjen e këtyre pasurive.*

17.9 Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Brahimi, ndër të tjera, ka pretenduar që në të ardhurat e vitit 2007 të përfshihet vlera totale e shitjes së automjetit me targë ***, prej 760.000 lekësh, si dhe ka kërkuar t’i vlerësohen si të ligjshme të ardhurat e deklaruara në DV – 2008, në shumën 295.000 lekë, nga qiradhënia e njësisë së shërbimit.

17.10 Komisioni, pas administrimit të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, në përfundim, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mangësi financiare në total në shumën prej -526.113 lekësh gjatë periudhës 2003 - 2016⁵, dhe ka konkluduar se: [...] *trupit gjykues, pas analizimit të provave shitesë të paraqitura nga subjekti dhe vlerësimeve përkatëse të kryera në raport me ligjin e zbatueshëm, çmon se – duke e parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe në tërësinë e tij kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi – kjo mungesë financiare, si dhe pasaktësitë e konstatuara në deklarime, në vetvete, nuk kanë një peshë të tillë që të mund të përbëjë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Irena Brahimi, sipas parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016 [...] (f. 21 e vendimit).*

17.11 Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve, vlerëson se hetimi i Komisionit mbi burimet e ligjshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të paluajtshme: “Apartament banimi me sip. 95.30 m²” dhe “Njësi shërbimi me sip. 50 m²”, nuk paraqitet i plotë, përkundrejt rrethanave që janë konstatuar si vijon:

17.11.1 Në DV-2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burime krijimi të këtyre pasurive, katër burime të ardhurash: *(i) kursimet familjare të deklaruara më parë, në shumën 2.300.000 lekë; (ii) kursimet e realizuara gjatë vitit 2008, në shumën 1.100.000 lekë; (iii) të ardhurat nga dhënia në përdorim e ambientit dhe (iv) hua.* Komisioneri Publik konstaton se, në vlerësim të akteve të administruara dhe jurisprudencës së Kolegjit,

⁵ Referuar akteve në dosje të Komisionit, shuma prej -526.113 lekë është totali i diferencave negative të konstatuara në vitet 2007, 2008.

çështjet që kërkojnë hetim të mëtejshëm janë analizimi dhe trajtimi i këtyre burimeve: (i) kursimet familjare të deklaruara më parë, në shumën 2.300.000 lekë dhe (ii) kursimet e realizuara gjatë vitit 2008, në shumën 1.100.000 lekë.

17.11.2 (i) Lidhur me burimin e deklaruar: kursimet familjare të deklaruara më parë, në shumën 2.300.000 lekë, referuar deklaratave periodike vjetore për vitet 2005, 2006, 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në total në shumën 2.300.000 lekë. Bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, Komisioneri Publik vëren se metodologjia e ndjekur nga Komisioni, për analizimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për krijimin e këtyre kursimeve *cash* për periudhën 2006 - 2007, nuk gjen mbështetje në jurisprudencën⁶ e deritanishme të Kolegjit, pasi:

- (i) për të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur ****.**** pranë laboratorit privat *“***”*, për vitet 2006 dhe 2007, është administruar vetëm një akt shkresor i thjeshtë nga punëdhënësi i pretenduar dhe subjektit të rivlerësimit nuk i është kërkuar të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave;
- (ii) për shpenzimet e jetesës për vitin 2007, llogaritjet e kryera nga Komisioni nuk janë bazuar në informacionin e dërguar nga ILDKPKI/INSTAT, por janë llogaritur si një mesatare e shpenzimeve të vitit 2006 dhe 2008;
- (iii) për shpenzimet e udhëtimit të kryera nga anëtarët e familjes Brahimi, vlerësohet e nevojshme rillogaritja e tyre duke u bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit.

17.11.3 (ii) Lidhur me burimin: kursimet e realizuara gjatë vitit 2008, në shumën 1.100.000 lekë, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të vitit edhe huan e marrë nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. ****.****, në shumën 30.000 euro, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare.

17.11.3.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe në këtë vit metodologjia e ndjekur nga Komisioni për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve të kryera nga anëtarët e familjes Brahimi, nuk mbështetet në jurisprudencën e Kolegjit.

17.11.4 Sa më sipër, Komisioneri Publik çmon të nevojshëm se Kolegji duhet të hetojë në funksion të kontrollit të ligjshmërisë të burimit financiar: “Kursime familjare të deklaruara në shumën 2.300.000 lekë” dhe të burimit financiar: “Kursime të realizuara gjatë vitit 2008, në shumën 1.100.000 lekë”, të cilat janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pasuritë: “Apartament banimi me sip. 95.30 m²” dhe “Njësi shërbimi me sip. 50 m²”.

18. Shpenzimet për shkollim

18.1 Lidhur me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, konstatohet se në vitet 2014-2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për shkollimin e dy vajzave të saj në institucione arsimore private, në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar, si vijon:

⁶ Vendimi (JR) nr. 11/2009, i Kolegjit të Posaçëm të Apelitimit.

18.2 Për vajzën ***.***

18.2.1 Në DV-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin pranë kolegjit “***.***”, Tiranë, për vitin shkollor 2014-2015, në shumën 2.100 euro. Subjekti deklaroi se vajza ka përfituar bursë në masën 60%.

18.2.2 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin pranë kolegjit “***.***”, Tiranë, deri në datën 31.12.2015, në shumën 2.030 euro. Subjekti deklaroi se vajza ka përfituar bursë në masën 60%.

18.2.3 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin e vajzës në “***.***.***”, Londër, Mbretëri e Bashkuar. Vajza ka fituar 100% bursë për shkollimin, ndërkohë që paguhet siguracioni, konvikt dhe ushqim. Është paguar deri në datën 31.12.2016, shuma 16.150 GBP dhe është ngrirë si garanci shuma 3.000 GBP.

18.2.4 Në DV-2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin e vajzës në “***.***.***”, Londër, Mbretëri e Bashkuar. Vajza ka fituar 100% bursë për shkollimin, ndërkohë që paguhet akomodimi. Paguar 12.205 GBP⁷.

18.3 Për vajzën ***.***

18.3.1 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin pranë kolegjit “***.***”, Tiranë, deri në datën 31.12.2015, në shumën 2.370 euro + 6.202 lekë.

18.3.2 Në DV-2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin pranë shkollës “***.***”, Tiranë në shumën 700 euro për vitin shkollor 2015-2016. Për vitin shkollor 2016-2017, vajza ka fituar 70% bursë dhe është paguar shuma 1.040 euro.

18.3.3 Në DV-2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arsimimin pranë shkollës “***.***”, Tiranë, në shumën 1.040 euro (vajza ka fituar 70% bursë).

18.3.4 Komisioneri Publik, nga aktet e administruara në dosje, konstaton se, në analizën e kryer nga Komisioni, shpenzimet lidhur me shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar, janë llogaritur bazuar vetëm në deklaratimet e subjektit⁸. Në dosjen e Komisionit, për efekt të hetimit të kryer prej tyre, edhe në referencë të qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji në jurisprudencën përkatëse, nuk rezultoi të jenë administruar akte provuese nga institucionet arsimore lidhur me sa pretendohet në mënyrë deklarative nga subjekti i rivlerësimit për: (i) bursat e përfituara nga këto institucione; (ii) tarifat e shkollimit, akomodimit, si dhe (iii) shpenzimet e jetesës të kryera nga fëmijët e subjektit të rivlerësimit, znj. Brahimi, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

18.3.5 Nga konstatimet e bazuara në të dhënat e *open source data* (faqja zyrtare e institucionit privat arsimor “***.***.***” Londër⁹) rezultoi se tarifat e këtij institucioni

⁷ Subjekti ka deklaruar se është paguar konvikt në shumën 12.470 GBP, nga e cila, për shkak të një ulje të çmimit si rrjedhojë e marrëveshjes me shkollën, konvikti ka kthyer shumën prej 215 GBP. Gjithashtu, subjekti deklaroi se nga shkolla është kthyer shuma prej 500 GBP, pjesë e shumës së bllokuar si garanci monetare, si dhe është paguar siguracion në shumën 450 GBP. Gjithashtu, nga informacioni i dërguar nga *** Bank konstatohet se nga llogaria bankare në emër të ***.*** janë transferuar 12.470 GBP, në datën ***.6.2017, me përshkrimin: “... ***.*** ***.***.*** ..., London/ For Study”.

⁸ Referohuni metodologjisë financiare në faqen nr. 21 të rezultateve të hetimit, kryesisht.

⁹ <https://www.kps.co.uk/userfiles/files/KPS%20Schedule%20of%20Fees%20International%202020-21.pdf>

për studentët ndërkombëtarë për një vit akademik (shkollim, akomodim, shpenzime shtesë) janë të një vlerë rreth 50.000 GBP¹⁰.

18.4 Sa më sipër, Komisioneri Publik, marrë në konsideratë informacionin mbi kostot e larta të studimeve, kryesisht në Mbretërinë e Bashkuar, vlerëson si të nevojshëm administrimin e dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me: (i) bursat e përfituara nga këto institucione; (ii) tarifat e shkollimit, akomodimit dhe (iii) shpenzimet e jetesës, në mënyrë që të konkludohet mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e kryera për vitet 2014-2016, pasi rezultojnë këto shpenzime janë një zë i konsiderueshëm në analizën financiare për këtë periudhë.

19. Konstatime të tjera

19.1 Përveç sa më sipër trajtuar, bazuar në aktet e administruara në dosje,¹¹ Komisioneri Publik konstaton se metodologjia e ndjekur nga Komisioni, për analizimin e burimeve të ligjshme për periudhën 2014-2016, nuk është e qartë dhe nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në dosje të Komisionit, për sa vijon:

(i) Bazuar në shkresën e ISSH-së nr. *** prot., datë ***.12.2018, dhe shkresën e DPT-së nr.*** prot., datë ***.8.2019, rezultojnë se bashkëshorti i subjektit, nga punësimi pranë laboratorit privat “****”, për periudhën 2014-2016, ka përfituar pagë në masën 3.600 lekë bruto/muaj¹², dhe jo në shumën 360.000 lekë/vit, siç deklarohet në deklaratën periodike vjetore dhe në vërtetimin e laboratorit “****”¹³.

(ii) Përfshirja në mesin e burimeve të ligjshme e të ardhurave të deklaruara me burim nga qiraja e njësisë për vitin 2014, në shumën 432.000 lekë, për të cilat detyrimet tatimore rezultojnë të jenë paguar në datën ***.3.2020¹⁴, nuk është në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, që në vendimin nr. 8. datë 16.4.2019, prg. 63, ka mbajtur qëndrimin se: [...] *“tatimet e paguara gjatë procesit të rivlerësimit, për të ardhurat e viteve 2006-2012, nuk e bindin trupin gjykues për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, pasi duket qartë që kjo pagesë është bërë për efekt të procesit të rivlerësimit”* [...].

(iii) Sa i përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se shpenzimet për udhëtimet e bashkëshortit në drejtim të Janinës janë mbuluar nga laboratorit “****”, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezultojnë të jenë provuar pretendimet e subjektit lidhur me këto shpenzime. Në vërtetimin e lëshuar nga laboratorit “****”, në datën ***.12.2019, në të cilin citohet se punëdhënësi ka përbaluar/rimbursuar të gjitha shpenzimet e udhëtimit të kryera nga z. ***.***, vajtje dhe kthim brenda ditës, me destinacion në Janinë, nuk identifikohen datat e sakta të udhëtimeve të kryera, shumat e rimbursuara, si dhe nuk është dorëzuar ndonjë dokumentacion financiar justifikues.

¹⁰ Tarifa e shkollimit varion nga 24.500 GBP deri në 25.500 GBP; Tarifa e akomodimit varion nga 15.900 GBP deri në 24.000 GBP; Pagesë garancie, në vlerë prej 2.750 GBP dhe tarifë regjistrimi, në vlerë prej 250 GBP; Pagesë siguracioni, në vlerë 450 GBP dhe tarifë transferimi në aeroport, në vlerë prej 225 GBP.

¹¹ Referohuni analizës financiare të administruar në dosje të Komisionit.

¹² Rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka përfituar tri paga, në masën 3.600 lekë/bruto, në vitin 2014 dhe 12 paga në vit, për vitet 2015 dhe 2016.

¹³ Vërtetim, datë ***.10.2016, nga Klinika mjekësore “****”.

¹⁴ Referohuni mandatarikëtimit datë ***.3.2020, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me parashtrimet përfundimtare.

19.2 Nuk rezulton që Komisioni të ketë llogaritur shpenzimet për udhëtimet e personave të lidhur, bashkëshortit dhe vajzës së subjektit të rivlerësimit drejt Mbretërisë së Bashkuar, në vitin 2016¹⁵.

19.3 Komisioneri Publik çmon se është i nevojshëm zhvillimi i hetimit në funksion të kontrollit të ligjshmërisë të burimeve financiare, që kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të realizuara për periudhën 2014-2016.

III.B Për vlerësimin e aftësive profesionale

20. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik gjendet në pamundësi të ushtrimit të kontrollit dhe më pas të vlerësimit të këtij kriteri, për shkak të rrethanave në vijim:

21. *Çështje civile e shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.5.2015*

21.1 Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2020, dërgoi pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, vendimin nr. 276/1, datë 19.10.2020, “Për korrigjimin e vendimit nr. 276, datë 21.7.2020”, i cili, ballafaquar me kërkesat e nenit 57¹⁶ të ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të përmbajë pjesën përshkruese–arsyetuese, ndërkohë përmban pjesën hyrëse dhe atë urdhëruese.

21.2 Në pjesën hyrëse vërejmë se Komisioni ka konstatuar se, në vendimin nr. 276, datë 21.7.2020, në dispozitiv të vendimit nuk është përshkruar pika 2, siç është vendosur dhe shpallur në seancën e datës 21.7.2020, ndaj dhe, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative, ka vendosur për korrigjimin/zëvendësimin e pikës 2 të dispozitivit.

21.3 Në pjesën urdhëruese të vendimit, për korrigjim vendimi, konstatohet se është parashtruar si vijon [...] Në dispozitivin e vendimit nr. 276, datë 21.7.2020, pas pikës 1, të shtohet pika 2, me këtë përmbajtje: “*Transferimin e çështjes civile – me palë ndërgjyqëse: paditës ***.*** e të paditur: Zyra Përmbartimore “***.***.*** & ***” sh.p.k., dhe me objekt: “Kundërshtimi i veprimeve përmbartimore” – të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë dhe të përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.5.2015, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

21.4 Në vendimin e korrigjimit nr. 276/1, datë 19.10.2020, mungon pjesa përshkruese-arsyetuese, ku duhet të pasqyroheshin rrethanat e çështjes civile përkatëse, si dhe shkaqet për të cilat është vendosur transferimi i saj për inspektim, sikurse kërkon pika 4 e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pra: “*evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore*” apo “*shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik*”, të magjistratit. Edhe në vendimin nr. 276, datë 19.10.2020, objekt korrigjimi nuk konstatohet se arsyetohet për këtë çështje civile, që është vendosur të transferohet në institucionin përgjegjës.

¹⁵ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në Pyetësorin nr. 1.

¹⁶ Neni 57, “Vendimi i Komisionit”, pika 2, “Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese”.

21.5 Komisioneri Publik, në këtë situatë procedurale dhe ligjore, të përshkruar më lart, konstaton pamundësinë e shqyrtimit dhe më pas vlerësimin përkatës për sa vendosur mbi transferimin e çështjes civile të shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe të përfunduar me vendimin nr. ***, datë ***.5.2015, ndaj e paraqet në këtë ankim për t'u vlerësuar gjatë shqyrtimit të ankimit në procedurën e apelimit në Kolegj.

22. Denoncim publik i një portali mediatik

22.1 Nga përmbajtja e një denoncimi publik të një portali mediatik, të dërguar më datë 9.10.2020, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, nëpërmjet postës elektronike nga institucionet e rivlerësimit, vërehen të dhëna që ngrenë pretendime dhe dyshime mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Brahimi, në vendimmarrjen e një çështje penale, për të pandehurin ***.***, për veprën penale të parashikuar nga neni 290, pika 4 e Kodit Penal.

22.2 Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, nuk rezultojnë të jetë paraqitur dhe administruar ndonjë denoncim lidhur me këtë çështje, si rrjedhojë edhe nuk është kryer hetim administrativ në përfundim të të cilit edhe subjekti i rivlerësimit do të njihej dhe paraqiste shpjegimet e tij.

22.3 Referuar përmbajtjes së denoncimit, kjo ngjarje e datës ***.7.2016 është e pasqyruar në lajmet e kronikës së datës ***.7.2016, në të paktën një media kombëtare, ku referohet emri i shtetasit ***.*** dhe në Gjykatën e Lartë rezultojnë se ka një çështje penale themeli në shqyrtim, me datë regjistrimi ***.1.2019, që i përket: *Rekursuesi* – Prokuroria e Apelit Gjyrokastër, *me objekt akuze*: Kryerja e veprës penale – “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, neni 290, paragrafi 4 i Kodit Penal”, *i pandehur*: ***.***, *me status të çështjes*: në studim/shqyrtim.

IV. Kërkimi i ankimit

23. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

24. Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit C/2, Ç dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vendimin nr. 276, datë 21.7.2020, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se në rastin konkret, në analizë të të tria kritereve të rivlerësimit, gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

25. Mbështetur në parashikimin e nenit F, pikat 3 dhe 7 të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas vlerësimit tërësor të procedurave, për subjektin e rivlerësimit, znj. Irena Brahimi, në përfundim të gjykimit të çështjes, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 276, datë 21.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,
ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA